

Rilind Dauti¹

UDC: 327(496.5:497.2)"1878/2023"
341.232(496.5:497.2)"1878/2023"

**ULJE-NGRITJET NË MARRËDHËNIET POLITIKE NË MES
SHQIPTARËVE DHE BULLGARËVE (NGA VITI 1878 DERI MË SOT)**

**ПОДЕМИ И ПАДОВИ ВО ПОЛИТИЧКИТЕ ОДНОСИ МЕЃУ
АЛБАНЦИТЕ И БУГАРИТЕ (ОД 1878 ДОСЕГА)**

**UPS AND DOWNS IN THE POLITICAL RELATIONS BETWEEN
ALBANIANS AND BULGARIANS (FROM 1878 TO THE PRESENT)**

Abstract

While the political relations between Albanians and Serbs, as well as between Albanians and Greeks, are mainly characterized by enmity (and few episodes of friendship or cooperation), during the course of history the political relations between Albanians and Bulgarians have had a different trend, with more cooperation and less conflict.

This paper will be a chronological summary of the most characteristic developments throughout history, starting from 1878 until the more recent days.

The main motive the cooperation was to fight the common enemies, while the few clashes happened around the claims to the same territories.

In this paper, by “political relations” is not only meant the relations between sovereign states, but also the activities of violent non-state actors such as VMRO, diaspora organizations that were politically engaged, as well as individual initiatives that were similar or close to what is known today as citizen diplomacy.

Keywords: Albanians, Bulgarians, cooperation, Macedonia, Balkans

¹ Kandidat për doktoratë në Universitetin e Evropës Juglindore, Shkup&Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. rilind_dauti@hotmail.com

Hyrje

Kontaktet në mes shqiptarëve dhe bullgarëve datojnë që nga koha e mesjetës. Në fakt, ka mundësi që dokumenti më i hershëm që i përmend shqiptarët është pikërisht në një dokument në bullgarishten e vjetër të shkruar në fillimin e shekullit XI.²

Të thuash sot që shqiptarët dhe bullgarët janë popuj fqinjë është shumë problematike duke e pasur parasysh praninë e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërmjet tyre, por në vitin 1515 pikërisht këtë e thoshte fisniku shqiptar Gjon Muzaka në “Kronikën” e tij, ku shprehet se afër malit Pelister gjendet kufiri midis Shqipërisë dhe Bullgarisë.³ Gjon Muzaka këtë e ka shkruar si i mërguar në Itali në një kohë kur edhe Shqipëria edhe Bullgaria ishin nën sovranitetin e Perandorisë Osmane ku qëndruan deri më 1908 dhe 1912, respektivisht.

Për këtë periudhë tek popujt ortodoksë në Ballkan ekziston një stereotipizim negativ i shqiptarëve si mjet i osmanëve për shtypjen e ballkanasve tjerë. Kjo akuzë është shumë thjeshtëzuese, e gjeneralizuar, dhe e injoron faktin që në këtë kohë shqiptarët nuk kishin kontroll të plotë në vendimmarrje, por me aq mundësi sa kishin, shpesh e kanë sfiduar autoritetin e Perandorisë Osmane, prandaj dhe më 1830 në Manastir ndodhi masakra e bejlerëve etnikisht shqiptarë, por që nuk i parandaloi kryengritjet e shqiptarëve në vitet 1843-1847.

Këto kryengritje na sjellin edhe te një fenomen tjetër: p.sh. në shtypjen e Kryengritjes së Dervish Carës (pra shqiptarëve) Perandorisë Osmane i ndihmuan shqiptarë tjerë!⁴ Kështu që, nëse shqiptarët paskan qenë mjet i Perandorisë Osmane për shtypjen e popujve tjerë, shqiptarët shumë më shumë luftonin kundër njëri-tjetrit! Ishin shumë të zakonshme luftimet e njërit pashallëk me sundues shqiptar kundër ndonjë pashallëku fqinj me në krye po ashtu një shqiptar. Kjo dhunë brendashqiptare para zgjimit kombëtar të tyre vlen edhe për fenomenin e plaçkitjes në atë që sot është pjesa veri-perëndimore e Maqedonisë së Veriut. Këtij stereotipi, pa qëllim nga ana e tij i ka “ndihmuar” poeti Gligor Përliçev me poemën “Serdarot” ku flet për një përballje epike në mes hordave geqe kundër sllavëve të Rekës, por në versionin origjinal të veprës “O Armato-llos”, vet heroi Kuzman Kapidani po ashtu ishte shqiptar. Dhe pikërisht ky version është më afër të vërtetës historike, sepse bandat plaçkitëse të asaj kohe

² Grujic, Radoslav. “Legenda iz vremena Cara Samuila o poreklu Naroda”. në: *Glasnik skopskog naucnog drustva*, Shkup, 13 (1934), f. 198-200. Cit. sipas Elsie, Robert. “1000 — 1018 Anonymous: Fragment on the Origins of Nations”, në http://www.albanianhistory.net/1000_Origins-of-Nations/, marrë më datë 24.11.2022

³ Muzaka, Gjon. “Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi. Per Giovanni Musachi, despoto d’Epiro”, më *Chroniques gréco-romanes inédites ou peu connues publiées avec notes et tables généalogiques*, ed. Hopf, Charles. Berlin, 1873, f. 270-340. Cit. sipas Elsie, Robert. “1515 John Musachi: Brief Chronicle on the Descendants of our Musachi Dynasty”, në http://www.albanianhistory.net/1515_Musachi/index.html, marrë më datë 24.11.2022.

⁴ Matkovski, Aleksandar. *KRYENGRITJA E DERVISH CARËS (monografi)*, Tetovë, 2012, f. 212

nuk e kursenin askënd: vizitorë të huaj, njerëz lokalë, shqiptarë tjerë, madje vet autoritetet osmane kishin vështirësi t'i vënë nën kontroll.

Kjo ishte një hyrje e shkurtër për t'i hedhur poshtë mitet për gjoja shqiptarët si vegël e osmanëve për shtypjen e popujve tjerë ballkanikë përfshirë dhe bullgarët, që edhe sikur të kishin ndodhur, kanë ndodhur në një kohë kur mungonte identiteti kombëtar kështu që nuk bëhej fjalë për motiv kombëtar e as për supremaci të njërit grup etnik ndaj tjetrit, sepse siç u tha, në këtë kohë shqiptarët ashpërsisht luftonin edhe kundër njëri-tjetrit.

Marrëdhëniet shqiptaro-bullgare në kohën e zgjimit kombëtar

Megjithatë, një fërkim i shkurtë me motiv me të vërtetë kombëtar midis shqiptarëve dhe bullgarëve ndodhi më 1878 pas Marrëveshjes së Shën Stefanit. Me këtë marrëveshje parashihej krijimi i një Bullgarie që do të shtrihet deri në Korçë. Pra, kjo Bullgari do të përfshinte edhe shumë territore të banuara me shqiptarë. Për këtë arsye elita shqiptare e asaj kohe i dërguan memorandume Fuqive të Mëdha ku i kundërshtonin vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Ky fërkim midis projeksioneve shqiptare dhe bullgare zgjati shumë shkurtë, sepse më 13 korrik 1878 Traktati i Shën Stefanit zëvendësohet me Traktatin e Berlinit që e krijon një shtet bullgar shumë më të vogël, që aspak nuk përfshinte territore të banuara me shqiptarë, prandaj dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit më nuk kishte arsye për brengosje për shtrirjen e Bullgarisë në treva të banuara me shqiptarë por e gjithë përpjekja e saj u koncentrua në përballjen kundër Greqisë, Serbisë, dhe mbi të gjitha kundër Malit të Zi që Kongresi i Berlinit ia dhuroi Tivarin dhe Ulqinin.

Me shtypjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga Perandoria Osmane më 1881, u ndërpre përkohësisht lufta e armatosur e shqiptarëve, por vazhdoi me punë Lëvizja Kombëtare Shqiptare përmes botimit të librave dhe pamfleteve shqip, lobimit tek të huajt, etj. Në këtë kohë u krijuan disa shoqata miqësie në mes shqiptarëve dhe bullgarëve. Më 1887 në Sofje themelohet organizata revolucionare shqiptaro-maqedonase, më 1898 në Londër themelohet **Lidhja Qendrore Shqiptaro-Maqedonase**, dhe në Sarajevën nën Austro-Hungari, u themelua **Klubi Kulturor Maqedonas-Shqiptar**.⁵

Por rasti më serioz është ekzistimi kolonisë shqiptare në Sofje. Këta ishin artistë dhe intelektualë të angazhuar politikisht në frymën e nacionalizmit shqiptar. Qëndrimet e tyre ata i shprehnin te gazetatat e botuara në Sofje: "Drita" dhe "Shqypeja e Shqypnisë". Autoritetet bullgare e lejonin veprimtarinë e tyre edhe pse ndonjëherë qëndrimet e tyre binin ndesh me projeksionet territoriale

⁵ Asani, Skender. *KRYENGRITJA E PËRGJITHSHME SHQIPTARE E VITIT 1912 (Janar-Gusht) SIPAS BURIMEVE BULLGARE*, Shkup, 2010, f. 12-14.

bullgare për të ardhmen, siç është rasti me poetin Josif Bageri që në poezitë e tij viset si Shkupin dhe Manastirin i përmendte si pjesë të Shqipërisë.⁶

Territoret e tilla që pretendoheshin nga të dyja palët ishin arsyeja kryesore përse ideologu i nacionalizmit shqiptar, Sami Frashëri, në traktatin e tij “Shqipëria çka qenë, ç’është, dhe ç’do të bëhetë” (botuar më 1899), te kapitulli VII “Rreziqet e Shqipërisë”, bashkë me turqit, Malin e Zi, Serbinë, dhe Greqinë, e përmend edhe Bullgarinë si rrezik për interesat shqiptare.⁷

Megjithatë, përderisa këto territore ishin në status-kuonë e të qenurit nën sovranitetin e Perandorisë Osmane, nuk shkaktonin armiqësi në mes dy popujve. Në fakt, kah fundi i sundimit osman kur u paraqitën grupe të armatosura shqiptarësh që i sulmonin ushtarët dhe administratën osmane, kishte bashkëpunim në mes shqiptarëve dhe bullgarëve, siç është rasti me çetën e Çerçiz Topullit që bashkëpunonte me komitët e Maqedonisë. Një rast tjetër interesant është gjatë kohës sa ishin deputetë në Parlamentin Osman bashkëpunimi në mes shqiptarit Hasan Prishtina me bullgarin Todor Pavlllov.

Kjo periudhë i shënon edhe përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që “me të mirë” ta bindin qeverinë osmane që t’i mbajë premtimet e saj kur vjen puna te të drejtat e shqiptarëve. Kur fjalët dështuan, më janar 1912 në lagjen Taksim të Stambollit, Ismail Qemal Vlora dhe Hasan Prishtina u morën vesh për fillimin e një kryengritje, më e madhja nga kryengritjet shqiptare prej 1909-s që kishin karakter lokal.

Për këtë kryengritje burimet bullgare (qeveritare dhe të tjera) fillimisht do të raportojnë nga prizmi neutral, në mos me simpati ndaj shqiptarëve. Por, kur kryengritësit shqiptarë i marrin qytetet të cilat i pretendonte edhe Bullgaria, si Shkupi, Presheva, Tetova, etj., burimet bullgare kryengritësve shqiptarë fillojnë t’iu referohen si barbarë, dhunues, dhe plaçkitës.⁸

Kryengritja Gjithëshqiptare e vitit 1912 kulminoi me pranimin e kërkesës që daton qysh prej 1878-s, kur më 4 shtator 1912 qeveria osmane më në fund e aprovoi krijimin e një vilajeti unik shqiptar. Kjo njësi administrative në kuadër të Perandorisë Osmane, herdo-kurdo në ato kufij do të shndërrohej në Shqipërinë e Pavarur. Një përfundim i tillë i paralajmëruar ishte i papranueshëm për Serbinë, Malin e Zi, dhe Greqinë, që kishin pretendime të marrin kontroll mbi sa më shumë territore të banuara me shqiptarë, kështu që me pretekstin e çlirimit të Ballkanit, i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Një Shqipëri e tillë binte ndesh edhe me politikat e Bullgarisë sepse përfshinte edhe vendbanime ku jetonin njerëz me vetidentifikim bullgar, por që me gjasë këto kufij do të mund të korrigjoheshin në mënyrë paqësore me marrëveshje, ose do të zgjidhej me këmbim të popullsive që në atë kohë nuk ishte tabu.

⁶ Bageri, Josif. *KOPËSHI MALSORI dhe Letërkëmbime*, Shkup, 2012, f. 103 & 137

⁷ Frashëri, Sami. *Shqipëria çka qenë, ç’është, dhe ç’do të bëhetë*, Bukuresht, 1899, f. 62-67

⁸ Asani, Skender. *KRYENGRITJA E PËRGJITHSHME SHQIPTARE E VITIT 1912 (Janar - Gusht) SIPAS BURIMEVE BULLGARE*, Shkup, 2010, f. 123

Megjithatë, me qëllimin e saj që më në fund të çlirohen krishterët e Ballkanit, Bullgaria u ngut dhe e ndërmoi atë që doli të jetë akt katastrofik vetdëmtimi që i ndjen pasojat sot e kësaj dite, kur kësaj lufte për “çlirim” e që motiv i vërtetë i 3 aleatëve tjerë ishin pretendimet ndaj vendbanimeve shqiptare, në mënyrë shkurtpamëse i hyri edhe Bullgaria.

Lufta e parë ballkanike: dëm për të dyja kauzat

Lufta formalisht i qe shpallur Perandorisë Osmane, por cak kryesor ishin tokat shqiptare. Kjo i vendosi shqiptarët në pozitë të vështirë. Nga njëra anë ishte imperativi i mbrojtjes së Shqipërisë (atë kohë nën sovranitetin e Perandorisë Osmane), nga ana tjetër ishte frika që para Fuqive të Mëdha mos të dalin si humbës bashkë me Perandorinë Osmane dhe kështu të legjitimohet pushtimi i tokave shqiptare nga Mali i Zi, Serbia, dhe Greqia. Në fund, vendimi i shumicës së shqiptarëve ishte të luftohet kundër shteteve fqinje ashtu që të realizohet projekti i autonomisë që një ditë të kulminojë me pavarësinë e Shqipërisë. Një thirrje e tillë u bë pa dallime fetare, përfshirë dhe shqiptarët ortodoksë si Fan Noli dhe prifti Naum Care në mbledhjen e organizuar nga shoqata e njohur e diasporës shqiptare në SHBA, “Vatra”. Ndërkaq, ajo që është më relevante për këtë punim, një thirrje e tillë u përçua edhe nga gazeta “Liri e Shqipërisë” e kolonisë shqiptare në Sofje.⁹

Ky qëndrim i shqiptarëve nuk çoi në përballje të armatosur të tyre me Bullgarinë, sepse luftimet e Bullgarisë u bënë larg vendbanimeve shqiptare, në Vilajetin e Edrenes. Por kjo qasje i vendosi shqiptarët përballë aleatëve të Bullgarisë, pra kundër Greqisë, Serbisë, dhe Malit të Zi.

Aleanca e Bullgarisë me shtetet e lartpërmendura nuk erdhi papritmas, por ishte kulminacion i përafrimeve që u karakterizuan me shumë marrëveshje. Megjithatë, afrimi i Bullgarisë me këto shtete rezultoi të jetë gabim katastrofik strategjik që i dëmtoi jo vetëm shqiptarët të cilët te bullgarët shihnin aleatë, por u dëmtuan edhe vet bullgarët. Më saktë: përderisa Bullgaria e luajti rolin kryesor në dëbimin përfundimtar të Perandorisë Osmane, tre aleatët tjerë ishin të zënë me masakra ndaj shqiptarëve, dhe në fund vet Bullgaria doli e dëmtuar nga dredhia mbi ndarjen e Maqedonisë, sepse Serbia dhe Greqia morën mijëra kilometra katrorë të banuara me popullsi që kishte vetëdije bullgare e që u bë cak i diskriminimit, shtypjes, dhunës, dhe debullgarizimit.

Pra, Lufta e Parë Ballkanike u nis me qëllim të keq ndaj shqiptarëve, por në fund dolën të dëmtuar edhe shqiptarët edhe bullgarët. Megjithatë, vlen të përmendet se në këtë kohë Bullgaria në parim e mbështeste krijimin e Shqipërisë së Pavarur (pa pjesët që edhe Bullgaria i pretendonte për vete) përderisa Serbia, Mali i Zi, dhe Greqia, nuk donin të ekzistojë kurrfarë Shqipërie, ose nëse është patjetër, le të ekzistojë por sipas parametrave ruse dhe franceze

⁹ Buxhovi, Jusuf. *Kosova (Perandoria Osmane)*, Prishtinë&Houston, 2012, f. 598

në kufij minimal prej 12,000 km² (pak më e madhe se Kosova e sotme). Në fund, kompromisi midis Fuqive të Mëdha ishte shteti shqiptar në rreth 28,000 km² sa i ka edhe sot.

Prej vitit 1913 kur u morën vendime edhe kundër shqiptarëve edhe kundër bullgarëve, zënë fill edhe përpjekjet e tyre për ndryshimin e këtyre vendimeve, herë pas here edhe së bashku. Ndërlidhës kryesor i këtij bashkëpunimi ishte Petar Çaulevi.¹⁰ Ky bashkëpunim midis shqiptarëve dhe bullgarëve fillon me Kryengritje e Ohrit-Dibrës kundër Mbretërisë së Serbisë.¹¹ Kjo kryengritje e gëzoi mbështetjen edhe të qeverisë shqiptare të Ismail Qemal bej Vlorës dhe në luftime mori pjesë edhe heroi i mirënjohur i popullit shqiptar, Isa Boletini. Pas çlirimit të Dibrës dhe Ohrit, fryma e bashkëpunimit në mes shqiptarëve dhe bullgarëve u dëshmuar me krijimin e qeverisjes lokale me përfaqësuese nga të dy popujt.¹² Por kryengritja dështoi, pas çka pasoi migrim i dhjetëra mijë banorëve të Maqedonisë së Vardarit në drejtim të shtetit shqiptar dhe atij bullgar, respektivisht.

Luftërat botërore: mikro-tendosje

Një vit më vonë plasi Lufta e Parë Botërore që e gjeti shtetin e sapolindur shqiptar të pafuqishëm nga të gjitha aspektet, prandaj ushtritë e huaja lirisht hynin e dilnin nëpër Shqipëri. Më 1915 kështu bëri edhe Bullgaria dhe aleatja e saj Austro-Hungaria. Ashtu siç paraprakisht patën rezistuar ndaj Serbisë, kishte shqiptarë që rezistuan edhe kundër pranisë së Bullgarisë në vendbanimet shqiptare, gjë që çoi në burgosjen dhe internimin e tyre nga autoritetet bullgare, përfshirë dhe burgosjen e aktivistëve të njohur shqiptarë: Hasan Prishtinës dhe Jashar Erebarës.¹³

Bullgaria ishte dhe vazhdon të jetë mbështetëse e fortë e ekzistimit të shtetit shqiptar, por gjatë Luftës së Parë Botërore u paraqitën disa “luhatje” në këtë zotim të Bullgarisë kur u pa se mbase nuk do të mund t’i arrijë qëllimet fillestare përse i hyri luftës. Në këtë kohë propozuan ndarje të Shqipërisë disa përfaqësuese zyrtarë bullgarë: ambasadori i atëhershëm në Berlin, Dimitar Rizov, ish-konsulli në Durrës dhe ish-bashkëpunëtori i Hasan Prishtinës, Todor Pavlovi, madje dhe vet Cari Ferdinand.¹⁴

Por nga ana tjetër, është një fakt interesant që shumë shqiptarë nga territori i asaj që sot është Republika e Shqipërisë, Kosova, Sanxhaku, dhe

¹⁰ Asani, Skender. *Çaulevi dhe vepra e tij për Shqipërinë*, Shkup, 2015, f. 7

¹¹ Pançev, Anton. *Албански официоз за българите в Охридско-Дебърското въстание*, <http://www.mni.bg/2022/09/albanski-oficioz.html>, 28.09.2022, marrë më datë 01.12.2022

¹² Demeter, Gábor & Csaplár-Degovics, Krisztián. *Albanian-Bulgarian relations during the Balkan Wars and the Albanian-Macedonian uprising ('Third Balkan War', 1913)*, f. 9

¹³ Bego, Fabio. *Albanian-Bulgarian Relations in the Frame of the Great War: Initiatives, doubts, and failures*, 2020, f. 10

¹⁴ Po aty, f. 12

Maqedonia e Veriut, vullnetarisht iu bashkëngjitën administratës civile, si edhe ushtrisë austro-hungareze dhe bullgare për të luftuar në anën e tyre dhe për të mbajtur rend në territoret që ata i kishin nën kontroll. Pra, vetëm dy vite pas Kryengritjes së Ohrit-Dibrës, shqiptarët dhe bullgarët sërisht u bënë bashkë në luftime. Sipas një përlllogaritje, vetëm në Frontin e Selanikut kishte 15 mijë shqiptarë në radhët e ushtrisë bullgare.¹⁵

Lufta e Parë Botërore la pasoja katastrofike për të gjithë. Për shqiptarët kjo ishte shpartallimi i mbështetëses së madhe të shqiptarëve, Austro-Hungarisë, ndërsa Bullgaria edhe më tej humbi territore në favor të Greqisë, Serbisë, dhe Rumanisë.

Nga pikëpamja ushtarake Serbia ishte po ashtu humbëse sepse i vdiq 1/4 e popullsisë mashkullore, por e kishte fatin që ishte rreshtuar në anën e fituesve kështu që edhe ajo u shpall fitimtare e luftës. Me qëllim që kroatët ta evitojnë Serbinë e Madhe, dhe që sllovenët të jenë më sigurt në një shtet më të madh, vendosën që bashkë me Serbinë ta krijojnë Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve, dhe Sllovenëve. Por siç dihet, përkundër një emri të tillë, ky shtet ishte kryekëput i dominuar nga serbët. Dhe pikërisht në këtë periudhë ndodhi kolonizimi me serbë dhe malazezë i Maqedonisë së Vardarit. Këtij kolonizimi iu vunë përballë çeta të armatosura të shqiptarëve, por në masë më të madhe dhe më të organizuar e bënte VMRO-ja. Përderisa VMRO-ja ashpërsisht i sulmonte kolonistët serbë, ajo asnjëherë nuk i prekte shqiptarët, sepse i konsideronin bashkatdhetarë vendas të Maqedonisë. Në fakt, VMRO jo vetëm që nuk kishte armiqësi me shqiptarët por kishte marrëdhënie bashkëpunimi. Territori i shtetit shqiptar u bë bazë e sulmeve të VMRO-së në territorin e Mbretërisë SKS/Jugosllave, dhe më 1921 VMRO nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin “Mbrotja Kombëtare e Kosovës” kurse më 1933 u nënshkrua marrëveshje për luftë të përbashkët në mes kroatit Ante Paveliq, Hasan Prishtinës, dhe Ivan Mihajllovit. Për arsye të ndërlikuara objektive, këto marrëveshje nuk arritën të implementohen por meritojnë respekt që u nënshkruan. (Kurse më 1934 vet VMRO pushoi së ekzistuari.)

Dështimi në mes dy luftërave botërore i shqiptarëve dhe bullgarëve për t’u çliruar nga pushtimi serb çoi në ngjarjet e pashpjeguara në mes shqiptarëve dhe bullgarëve në territorin e RMV-së së sotme në periudhën 1941-1944. Siç dihet, pas pushtimit të Jugosllavisë nga Gjermania dhe Italia më 1941, pjesa më e madhe e asaj që sot është territori i Maqedonisë së Veriut deri te një pjesë e vogël e Kosovës iu dha Bullgarisë Cariste, kurse pjesa tjetër e asaj që sot është Maqedonia e Veriut iu dha Mbretënisë Shqiptare (që vet ishte nën Itali). Në këtë periudhë të shkurtë pati ndjenjë të madhe çlirimi te shqiptarët në perëndim, dhe në lindje te popullsia vendase sllavishtfolëse që me të madhe iu

¹⁵ Bello, Raqi. & Taluri, Ervis. *Çështja e minoritetit bullgar në Shqipëri (1912-1945) dhe përpjekjet për hapjen e shkollave në gjuhën amtare*, <https://sot.com.al/politike/eshtja-e-minoritetit-bullgar-neshqiperi-1912-1945-dhe-perpjekjet-per-h-i422747>, 10.02.2021, marrë më datë 03.12.2022

bashkëngjit administratës bullgare. Por kjo nuk ishte çlirim për shqiptarët dhe bullgarët në anët e kundërta të kufirit, sepse shqiptarët nën Bullgarinë Cariste dhe sllavët e Maqedonisë nën Mbretininë Shqiptare ishin cak i dhunës që çoi në migrime të përkohshme në të dy anët e kufirit (përfshirë dhe paraardhësit e autorit të këtij shkrimi). Historianët nuk kanë dhënë shpjegim të motivit të një dhune të tillë kur e ke parasysh që prej 1912-s shteti shqiptar nuk ka ushtruar dhunë ndaj sllavëve rreth liqenit të Prespës dhe vendbanimeve tyre të tjera në kufijtë e para 1941, ndërsa në mes dy luftërave botërore shqiptarët dhe bullgarët shpesh bashkëpunonin në mes vete, prandaj është e pakuptueshme çfarë e ka nxitur një dhunë të tillë të ndërsjellë gjatë periudhës 1941-1944.

Kur më shtator 1944 në Bullgari pushtetin e morën në dorë komunistët që i shpallën luftë Gjermanisë, kjo çoi në përplasje edhe me Mbretininë Shqiptare që ishte nën okupimin ushtarak gjerman por që kishte motiv të vetin për luftë sepse përpiqej t'i mbajë territoret që iu bashkëngjitën asaj në vitet 1941-1944, prandaj pati luftime me Ushtrinë Mbretërore Shqiptare, grupet paramilitare si Balli Kombëtar, dhe dobët të organizuara - aradhet vullnetare.

Lufta e ftohtë: miqësia, zigzage ideologjike, solidaritet në mërgim

Ashtu si më herët në Sofje, më nëntor 1944 edhe në Tiranë pushtetin e marrin në dorë komunistët. Të dy palët në emër të vëllazërisë së proletariatit ndërkombëtar dhe pamundësisë objektive, territoret me bullgarë ose shqiptarë në atë që sot është Serbi, Mal i Zi, Kosovë, dhe Maqedoni e Veriut, ia dorëzojnë Jugosllavisë së Titos. Por “muaji i mjaltit” i vëllazërisë ndërkombëtare komuniste zgjati shumë shkurtë sepse më 1948 ndodh prishja Tito-Stalin që çoi edhe në prishjen e marrëdhënieve të Jugosllavisë me Shqipërinë e Enver Hoxhës dhe Bullgarinë e Georgi Dimitrovit. Kjo bëri që në mes Shqipërisë komuniste dhe Bullgarisë të vendoset një hendek i madh territorial që ua pamundësonte që lirshëm të zhvillojnë marrëdhënie të afërta. Por përkundër kësaj pengese që e kishin në mes, shteti shqiptar prapëseprapë pati marrëdhënie shumë të afërta me Bullgarinë. Këto mbështeteshin në **Marrëveshjen për Miqësi, Bashkëpunim, dhe Ndihmë të Ndërsjellë** të nënshkruar më 16 dhjetor 1947 në rezidencën “Kriçim” nga Georgi Dimitrovi dhe Enver Hoxha.¹⁶ Në vitet e mëvonshme u nënshkruan edhe një morri marrëveshjesh tjera për fusha të caktuara veç e veç. Në këtë periudhë pati edhe vizita të ndërsjella të niveleve të ndryshme, deri te më të lartat. Më 1954 dhe 1958 në Sofje shkoi për vizitë kryetari i atëhershëm i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Mehmet Shehu, ndërsa nga ana tjetër në Tiranë më 1957 shkoi në vizitë zyrtare kryeministri i atëhershëm i Bullgarisë Anton Jugov, kurse më 1959 udhëtoi një delegacion i udhëhequr nga Todor Zhivkovi.¹⁷

¹⁶ Bovev, Bobi. *СТАПИ И СЪДЪРЖАНИЕ НА ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И АЛБАНИЯ ПРЕЗ XX ВЕК*, në УДК 327(497.2:496.5)«1912/2000», f. 273

¹⁷ По аты, f. 274

Por siç dihet, më 1961 stalinisti i përbetuar Enver Hoxha i ndërpret marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik të destalinizuesit Nikita Hrushçov, ndërsa kjo çoi në dëmtimin e marrëdhënieve edhe me shtetet tjera të bllokut të udhëhequr nga BRSS, përfshirë dhe Bullgarinë. Por janë bërë disa përjashtime: Tirana nuk i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Sofjen, dhe ishte pikërisht ambasada bullgare në Moskë ajo që e kishte autorizimin nga udhëheqësia shqiptare që t'i mbrojë interesat shqiptare në Bashkimin Sovjetik.¹⁸

Sa i përket shqiptarëve në Jugosllavi, nuk mund të thuhet diçka konkrete në lidhje me raportet me Bullgarinë. Tek disa prej tyre u zhvillua kujtesa kolektive për dhunën e ashpër të xhandarmërisë bullgare në periudhën 1941-1944, por nuk është se kjo ka ndikuar që te shqiptarët të zhvillohet urrejtje e madhe ndaj Bullgarisë sepse shqiptarët në Jugosllavi ishin nën dhunën dhe diskriminimin e ashpër të Jugosllavisë dhe republikave përbërëse të saj: Serbisë, Malit të Zi, dhe Maqedonisë, kështu që “qyteku bullgar” i periudhës së shkurtë 1941-1944 ishte një moment i parëndësishëm krahasuar me atë çfarë në kohë reale e përjetonin shqiptarët në Jugosllavi. Më 1974 gjërat përmirësohen me ngritjen e Kosovës në status të ngjashëm me republikat, dhe një nga të drejtat që kushtetuta jugosllave e 1974-s ua jepte republikave dhe krahinave ishte e drejta që të vendosin bashkëpunim me shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare në mënyrë autonome nga pushteti federal. Këtë të drejtë e shfrytëzonte edhe Kosova, që nëse gjurmohet tek arkivat, me gjasë mund të haset tek-tuk ndonjë kontakt edhe me Bullgarinë, por Kosova, dhe në përgjithësi shqiptarët në Jugosllavi, kishin një diapazon tepër të ngushtë të gjërave që mund t'i bënin në raport me Bullgarinë apo cilindo shtet tjetër.

Por ajo që duhet thënë është se po në këtë periudhë kishte marrëdhënie shumë miqësore ndërmjet bullgarëve dhe shqiptarëve në diasporë. Siç dihet, pas instalimit të regjimeve komuniste në Shqipëri dhe Jugosllavi, pati një numër të madh të shqiptarëve dhe bullgarëve që ikën nëpër shtetet perëndimore, që iu shtua numrit edhe ashtu të madh të mërgimtarëve që u patën zhvendosur në periudhën në mes dy luftërave botërore dhe më herët. Këto komunitete të diasporave në vendet përkatëse, në veçanti ata në SHBA, ishin shumë aktive politikisht me qëllim për ta ndryshuar situatën e popullit të tyre në atdhe. Kështu, përfaqësuesit e diasporës bullgare dhe shqiptare në SHBA shpesh i jepnin mbështetje publike qëndrimeve të njëri-tjetrit, disa shqiptarë duke shkuar aq larg sa i mbështetnin qëndrimet bullgare në lidhje me “maqedonizmin” ashtu siç e kuptojnë bullgarët, dhe në një paradë më 1963 në qytetin Bafallo pati marshim të përbashkët të një grupi të shqiptarëve dhe bullgarëve.¹⁹

¹⁸ Po aty, f. 277

¹⁹ Tashev, Spas. *Македонските Бугари и Албанците заедно во борбата со југословенскиот комунизам*, <https://tribuna.mk/makedonskite-bugari-i-albancite-zaedno-vo-borbata-so-jugoslovenskiot-komunizam/>, 05.10.2021, Shkup, marrë më datë 06.12.2022

Te diaspora bullgare në SHBA shquhej Organizata Patriotike Maqedonase (MPO) dhe organ i saj ishte gazeta “Makedonska Tribuna”, kurse kjo gazetë shpesh raportonte edhe për persekutimin e shqiptarëve nën Jugosllavi. Botuesi më markant i shkrimeve në këtë gazetë ishte udhëheqësi i fundit i VMRO-së, Vanço Mihajllovi, i cili iu dilte në mbrojtje shqiptarëve që shtypeshin nën Jugosllavi.²⁰ Madje, në një shkrim ai shkron aq larg sa, përkundër faktit që ishte bullgar krenar, e kritikonte Bullgarinë që me hyrjen në aleancë me Serbinë dhe Greqinë në Luftën e Parë Ballkanike, jo vetëm që i dëmtoi interesat bullgare por edhe shkaktoi që miliona shqiptarë të pushtohen nga Serbia dhe Greqia. Po ashtu, në traktatin që e përmbledhë vizionin e tij politik: “Maqedonia – Zvicra e Ballkanit”, edhe pse kritik ndaj nacionalistëve shqiptarë për hartën e Shqipërisë që përfshin dhe pjesë të Maqedonisë, ai prapëseprapë parashihte status të barabartë të shqiptarëve dhe gjuhës shqipe në shtetin e Maqedonisë ashtu siç e paramendonte ai.²¹ Ndërkaq, për Kosovën (të përmendur me emër) dhe (në mënyrë të nënkuptuar) për Çamërinë, Sanxhakun, dhe viset shqiptare që ranë nën Malin e Zi, shprehet se janë “faktikisht shqiptare” dhe ndaj tyre Shqipëria ka pretendime “tërësisht të drejta”.²²

Vitet '90 të shekullit XX: përgjegjësia njerëzore

Rënia e regjimeve komuniste në Evropë që ndodhi viteve 1989-1991, përfshirë dhe atë të Tiranës, bëri që të zhduket izolimi ideologjik në mes shteteve, gjë që solli edhe intensifikim të marrëdhënieve në mes shtetit shqiptar dhe atij bullgar. Kështu, viteve '90 pati shumë vizita të ndërsjella, u nënshkruan shumë marrëveshje, ndërsa dëshmi e rënies së pengesave ideologjike është fakti se qeveria shqiptare e udhëhequr nga djathtëtë e Sali Berishës dhe Aleksandër Meksit bashkëpunonin me bullgarët e spektrit të majtë të udhëhequr nga Ljuban Berov dhe Zhan Videnov. Nga ana tjetër, kryeministri bullgar nga spektri i djathtë, Ivan Kostov, zhvillonte bashkëpunim me kryeministrat shqiptarë nga Partia Socialiste: Fatos Nano, Pandeli Majko, dhe Ilir Meta.²³

Rënia e regjimeve totalitare komuniste solli liri në shumë vende, por nuk solli liri dhe drejtësi gjithkund. P.sh. shqiptarët në Kosovë tërë vitet '90 i kaluan nën sundimin e ashpër të Serbisë së Millosheviqit. Injorimi i rezistencës paqësore të Ibrahim Rugovës çoi te lufta e Kosovës, ndërsa kjo çoi te intervenimi i NATO-s. Këtu Bullgaria e dha kontributin e saj kur me shumicë të madhe të 154 vota “për” ndaj 84 “kundër”, parlamenti bullgar lejoi që

²⁰ Perv, Vladimir. *IN MEMORIAM: ИВАН МИХАЈЛОВ ГАВРИЛОВ*, <https://tribuna.mk/in-memoriam-ivan-mihajlov-gavrilov/>, 05.09.2019, marrë më datë 07.12.2022

²¹ Mihajllov, Vanço. *Македонија – Швајцарија на Балканот*, Shkup, 1995, f. 95

²² Po aty, f. 50

²³ Bobev, Bobi. *ЕТАПИ И СЪДЪРЖАНИЕ НА ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И АЛБАНИЯ ПРЕЗ ХХ ВЕК*, në УДК 327(497.2:496.5)«1912/2000», f. 281

hapësira ajrore e Bullgarisë të shfrytëzohet nga aeroplanët e NATO-s për bombardim të caqeve në Republikën Federale të Jugosllavisë, dhe në seancën parlamentare, ministrja e atëhershme bullgare për punët e jashtme, Nadezhda Mihajlllova, u shpreh që sikur Bullgaria mos ta bënte këtë, do të ishte problem moral i bashkëfajësisë së heshtur dhe (kontribut i) zgjatjes së luftës.²⁴

Mileniumi i ri: dialogji intra-sllave dhe proshqiptari strategjike

Gjatë konfliktit në Kosovë, më 23 shkurt 1999 Bullgaria nënshkroi marrëveshje me Maqedoninë për furnizim të kësaj të fundit me armë. Edhe pse qëllimi primar ishte forcimi i Maqedonisë në raport me RFJ-në e Millosheviqit²⁵, donacionet në armatim u shfrytëzuan vetëm gjatë konfliktit të vitit 2001 kundër kryengritësve shqiptarë. Këtë ndihmë gjatë konfliktit të 2001-shit sot e kësaj politikanët bullgarë ua përmendin maqedonasve si dëshmi e mbështetjes së Bullgarisë kur ka fërkime në marrëdhëniet në mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, kjo ndihmë në armatim kundër shqiptarëve më 2001, dhe fakti që politikanët bullgarë sot e kësaj dite krenohen me të, nuk shkaktojnë shumë iritacion te shqiptarët, sepse ata janë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e Bullgarisë ndaj maqedonasve, kështu që e kuptojnë që kjo mbështetje për policinë dhe ushtrinë maqedonase erdhi nga kujdesi ndaj maqedonasve e jo nga armiqësia ndaj shqiptarëve. Sot, partitë politike shqiptare janë mbështetës të kërkesës së Bullgarisë për futjen e bullgarëve në Kushtetutën e Maqedonisë së Veriut, dhe politika shqiptare në Maqedoninë e Veriut ka synim të përbashkët strategjik me Bullgarinë që është Korridorit 8. Një pikë tjetër e përbashkët që po rizbulohet tani është bashkëpunimi historik i shqiptarëve me VMRO-në dhe parametrat pluraliste me të cilat kjo organizatë e ka paramenduar Maqedoninë autonome apo të pavarur në të ardhmen.

Kur jemi te VMRO-ja, në hapjen e klubit në Manastir që e mban emrin e liderit të saj të fundit, Vanço Mihajlllov, erdhën kryeministri bullgar Kirill Petkov dhe ministrja e punëve të jashtme Teodora Gençovska. Përveç se në hapjen solemne të klubit, ata shkuan për vizitë edhe te vendi ku punohet në ndërtimin e largpërçuesit Manastir-Elbasan si pjesë e Korridorit 8. Në asnjërin prej dy vendeve që i vizituan në Manastir nuk u takuan me zyrtarë shtetërorë etnikisht maqedonas, por te kjo e dyta u takuan me MPJ të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmanin, dhe drejtorin e kompanisë shtetërore për transmission të energjisë elektrike MEPSO, Orhan Murtezani.²⁶ Pra, të dy etnikisht shqiptarë.

²⁴ Weydenthal, Jan de. & Kançeva, Stojanka. *Yugoslavia: Bulgaria Grants NATO Access To Airspace – Grudgingly*. 05.05.1999, <https://www.rferl.org/a/1091235.html>, marrë më date 10.12.2022

²⁵ Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk përbënte asnjë rrezik për Maqedoninë sepse kishte urdhër të prerë nga SHBA që nuk guxon të preket Maqedonia

²⁶ Бугарска делегација предводена од премиерот Петков во работна посета на изградбата на енергетската врска од Коридорот 8, 400 kV далекувод Битола –Елбасан,

Në mosmarrëveshjet RMV-Bullgari për figurat dhe ngjarjet historike, shqiptarët kryesisht rijnë anash dhe negociatat ua kanë lënë tërësisht historinë maqedonas. Megjithatë, ka disa figura publike shqiptare në shoqërinë civile, mediat, ish-diplomatë, etj. që shprehin kundërshti ndaj qëndrimeve të Bullgarisë për shkak të asaj që në psikologjinë sociale njihet si “ndikimi shoqëror normativ”. Pra, me qëllim që të pranohen më mirë në shoqërinë maqedonase, shprehin qëndrime kundër Bullgarisë. Personat e tillë janë të paktë në numër, dhe ata nuk kanë ndikim të madh as te vet shqiptarët, megjithatë, qëndrimet e tyre tek shumë bullgarë shkaktojnë iritim, ndërsa te një numër i vogël i tyre shkaktojnë edhe reagim në përgjithësi antishqiptar, duke e përmendur p.sh. akuzën në fillim të këtij punimi, që shqiptarët ishin vegël e Perandorisë Osmane. Këto reagime ndodhin në rrjetet sociale, ku po ashtu mund të hasen edhe disa bullgarë që për t’iu shkuar për hatri maqedonasve, shqiptarët i përmendin me pezhorativin e shpikur nga Beogradi “shiptari”, apo i provokojnë maqedonasit duke iu thënë “përderisa ju maqedonasit merreni kundër Bullgarinë, shqiptarët po jua marrin shtetin”. Megjithatë, këto raste janë relativisht të rralla, dhe nuk ndikojnë në qëndrimet zyrtare të Sofjes ndaj shqiptarëve. Qëndrimi tejet miqësor i Bullgarisë u pa pas aksidentit me autobus në autostradën në Bullgari, ku gati se të gjitha viktimat ishin etnikisht shqiptarë. Bullgaria shpalli ditë zie, e burgosi një person që në rrjetet sociale pat bërë tallje makabre, e hetoi rastin me kujdes, të mbijetuarve u mundësoi mjekim në spitalet bullgare, ndërsa të vdekurit i riadhesoi në Shkup me aeroplanë të Forcave Ajrore Bullgare, ku në aeroportin e Shkupit pilotët ushtarakë bullgarë shprehën respekt para familjarëve të viktimave.²⁷

Sa i përket raportit me shqiptarët jashtë Maqedonisë së Veriut, Bullgaria ka dëshmuar qëndrime shumë miqësore edhe ndaj Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës. Pavarësinë e shpallur më 17 shkurt, Bullgaria e njohu shpejt më 20 mars 2008.²⁸ Për Samitin BE – Ballkani Perëndimor në Sofje 2018, Spanja u kërcënuar me bojkot nëse në samit merr pjesë edhe Kosova, por nikoqiri Bullgaria prapëseprapë e ftoi Kosovën duke e injoruar shtetin shumë më të madh dhe bashkë-nëtar në BE, Spanjën. Një vit më vonë, Bojko Borisovi për shkak të Kosovës shkëmbeu fjalë të ashpra me Ivica Daçiqin e Serbisë. Eurodeputeti bullgar, Ilhan Qyçyk, është shprehur që BE duhet t’i liberalizojë vizat për Kosovën dhe që të gjitha anëtarët e BE-së duhet ta njohin shtetësinë e saj.²⁹

<https://www.mepso.com.mk/index.php/mk/component/content/article/69-mk-kategorii/doma/vesti-i-aktuelnosti/599-8-400-kv?Itemid=614>, 16:04:2022, Shkup, marrë më datë 12.12.2022

²⁷ *Пилотите на двата воено-транспортни авиони им оддадоа почит на семејствата на загинатите*, në TV21, <https://youtu.be/GuZ4yDa5dhc>, 03.12.2021, marrë më date 14.12.2022

²⁸ Sa për krahasim, Maqedonia vazhdonte të bëjë kalkulime me muaj të tërë deri sa e njohu më në fund në të njëjtën ditë me Malin e Zi më 9 tetor 2008, edhe atë vetëm pas një presioni të madh të partive shqiptare

²⁹ *Eurodeputeti bullgar: Është koha që BE-ja të heq vizat për Kosovën dhe të gjitha vendet anëtare të njohin shtetësinë e saj*, <https://kallxo.com/lajm/eurodeputeti-bullgar-eshte-koha-qe->

Bullgaria është mbështetëse e fortë edhe e integritit në BE të Republikës së Shqipërisë, por kjo e fundit u bë viktimë e politikës së Këshillit Evropian që të ecë në pako bashkë me Maqedoninë e Veriut. Meqenëse Bullgaria ka mosmarrëveshje me Maqedoninë e Veriut kështu që e shtyu hapjen e negociatave të BE-së me të, Brukseli e sakrifikoi hapjen e negociatave edhe me Republikën e Shqipërisë. Edhe pse shumë politikanë bullgarë dhe personalitete të fushave tjera u shprehën që Republika e Shqipërisë nuk duhet të jetë viktimë e Maqedonisë së Veriut prandaj le të ecë vet, kjo nuk mjaftoi që të pengohet kryeministri shqiptar Edi Rama nga shprehja e frustracionit ndaj Bullgarisë. Kundër këtyre sulmeve ndaj Bullgarisë reagan shumë intelektualë shqiptarë,³⁰ ndërsa edhe vet Edi Rama u përpoq ta zbusë gabimin duke përkujtuar që ka mjaftuar një telefonatë me Bojko Borisovin që miqësisht të merren vesh për njohjen e minoritetit bullgar në Shqipëri.³¹

Kur jemi te kjo popullsi, autoritetet shqiptare nuk i vendosin kurrfarë pengesash hapjes së shoqatave të tyre (në dallim nga ajo që e bën Maqedonia e Veriut), ndërsa për hir të tyre Bullgaria financon projekte infrastrukturore në viset e Prespës, Pogradecit, Korçës, Devollit, etj., por që këto projekte u sjellin dobi edhe qytetarëve me vetëdije tjera etnike që jetojnë në ato pjesë të Shqipërisë.

Conclusion

To conclude, it can be said that political relations between Albanians and Bulgarians throughout history have had many ups and downs. They have been motivated by pragmatism against long-term common enemies, while the frictions where their interests have clashed have been short-lived and have not left long-term damage either to the official relations between the states or to the non-state subjects that were politically active, such as armed insurgents or the diaspora. Hasan Prishtina himself, who was imprisoned by Bulgaria in 1916, after the end of the War, was the main initiator of cooperation with the Macedonian komitis. There have even been cases where, without any tangible interest but simply out of principledness, in their writings they defended the other party who was the target of oppression and discrimination, as is the case with Vanko Mihajlov's publications in defense of Albanians.

be-ja-te-heq-vizat-per-kosoven-dhe-te-gjitha-vendet-anetare-te-njohin-shtetesine-e-saj/, 13.03.2022, marrë më datë 14.12.2022

³⁰ Paņev, Anton. "Албански интелектуалци нападнаха Еди Рама заради антибългарската му реторика", në *Източник: бюлетин "Българите на Балканите и по света"*, 2022, бр.7, http://www.mni.bg/2022/07/blog-post_26.html?m=1, 26:07:2022, marrë më datë 16.12.2022

³¹ Rama, tjetër reagim për Bullgarinë (i kujton minoritetin bullgar në Shqipëri), <https://www.voxnews.al/politike/rama-tjeter-reagim-per-bullgarine-i-kujton-minoritetin-bullgar-ne-shqip-i12365>, 24.06:2022, marrë më date 16.12.2022

The area where the interests of Albanians and Bulgarians historically collide is a large part of what is now North Macedonia, as well as a territorial strip that starts from Mala Prespa in the Republic of Albania, extends through Kosovo, and ends in Serbia in what by Albanians is known as the Presheva Valley. Today, the circumstances have changed drastically, because Bulgaria respects the territorial integrity of the Republic of Albania and Kosovo while expecting from them to respect minority rights of the part of the population in these states that identify as ethnic Bulgarians, while for North Macedonia, Bulgaria protects it from any possible danger, which was also evidenced against the Albanians in the conflict of 2001, but this was a short moment, while today the Albanian politics in this country have a lot in common with the policies of Sofia, above all the construction of the Corridor 8. Outside the official policy is also the rediscovery of VMRO's ideals for the political arrangement of Macedonia, which is also compatible with the goals of the Albanians.

As a further recommendation, it would be that the stages and cases mentioned in this paper receive a more detailed treatment separately, and an interesting topic would be to investigate non-political, private, and/or cultural relations, between members of both peoples.

Recensentë:

Prof. Dr. Ali Pajaziti

Prof. Dr. Agron Rrustemi